



BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor 2009

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Qershor 2009





PËRMBAJTJA

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

PLANI I PUNËS 2009

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJI

TAKIMET E KOMISIONIT

VIZITAT NË TERREN

TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA

AKTIVITETET E KOMISIONIT NË TË ARDHMEN

MONITORIMI I PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS

STATISTIKA

PËRBËRJA E KOMISIONIT

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni Parlamentar për Integritim Evropian është njëri nga 11 komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës. Përbëhet nga 11 anëtarë që përfaqësojnë partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Në bazë të përshkrimit të detyrave, puna e këtij Komisioni konsiston në:

Monitorimin e procesit të harmonizimit të sistemit juridik të Kosovës me sistemin juridik të Unionit Evropian; monitorimin e procesit të harmonizimit të legjislacionit me *acquis communautaire*; shqyrtimin e projektligjeve të iniciuara për miratim nga Kuvendi, nga aspekti i përfrimit dhe përputhshmërisë së legjislacionit me *acquis communautaire*; bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet e Unionit Evropian në drejtim të integritit dhe anëtarësimit të Kosovës në Unionin Evropian; bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet e UE-së dhe shteteve tjera lidhur me integritin në UE; bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet evropiane në Kosovë, monitorimin e punës së Qeverisë në përmbushjen e obligimeve të marra nga institucionet e Kosovës dhe sidomos Kuvendit

Vijon faqe 3



ndaj institucioneve të Unionit Evropian; mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (EPAP); participimin dhe mbikëqyrjen e Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit të Kosovës; mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të ashtuquajtur “*Pre-accession*



Assistance (IPA)”; monitorimin e programeve donatore dhe të kooperimit të UE-se të dedikuara Kosovës; bashkëpunimi me institucionet gjegjëse në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës; monitorimi i zbatimit të detyrimeve të Kosovës

Të dala nga konventat e Këshillit të Evropës.; monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për Kosovën.

Plani i Punës 2009

Komisioni për Integritet Evropian është ndër komisionet e para që ka miratuar Planin e Punës. Për shkak të specifikave që ka ky Komision, fillimisht ka miratuar Planin gjashtë mujor mars-shtator 2008, të cilit iu është përmbajtur me përpikëri. Pas përmbushjes së Planit gjashtë mujor, Komisioni për IE ka miratuar Planin e punës shtator-dhjetor 2009. Në hartimin e Planit Komisioni kishte marrë parasysh, përveç Strategjinë legislative të Qeverisë edhe nevojën për monitorimin e zbatimit të obligimeve të Qeverisë për përmbushjen e standardeve të UE-së si dhe ofrimin e mbështetjes për procesin e integriteteve evropiane të Kosovës. Përveç Planit të Punës për Komision, si reagim ndaj Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, Komisioni për IE ka hartuar edhe Planin e Veprimit të Kuvendit për Sfidat që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, me të cilat ka paraparë veprime konkrete për të gjitha trupat e Kuvendit për të adresuar sfidat e identifikuar në Raportin e Progresit.



Shqyrtimi dhe amendamenti i projektligjeve

Përveç mbikëqyrjes së aktiviteteve të Qeverisë drejt përmbushjes së obligimeve për zbatimin e Planit të Integrimit Evropian të Kosovës 2008-2010, Komisioni për Integrit Evropiane ka edhe një rol specifik në shqyrtimin e projektligjeve gjatë fazës së amendamentimit Ky komision është përgjegjës për shqyrtim e të gjitha amendamenteve



të projektligjeve nga aspekti i përpunimit të legjislacionit të Unionit Evropian. Për të përmbushur këtë funksion, gjatë këtij viti Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e xx projektligjeve që janë shqyrtuar në Kuvendin e Kosovës.

Gjithashtu ky Komision është komision funksional për projektligjet që ndërliken me procesin e integritimeve. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009 nuk është proceduar asnjë projektligj për të cilin Komisioni për Integrit Evropiane do të duhej të ishte komision funksional, por ka shqyrtuar hollësisht Raportin e Progresit për Kosovën 2008, të Komisionit Evropian.

Takimet e Komisionit

Në bazë të Rregullores së punës Komisioni, mban së paku 2 takime gjatë muajit. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009, ky Komision ka përmbushur obligimet e parapara, madje i ka tejkaluar ato. Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur 13 takime, 3 vizita jashtë shtetit si dhe dy tryeza të rrumbullakëta për procesin e integritimeve evropiane, përkatësisht adresimin e sfidave të identifikuara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në procesin e integritimeve evropiane. Gjithashtu në funksionin të avancimit të raporteve miqësore, Komisioni ka pritur një delegacion parlamentar nga Kroacia dhe një nga Hungaria.



Vizitat në Terren

Për të promovuar e idenë e integrimit evropian të Kosovës dhe të punës së institucioneve të Kosovës në këtë proces, në veçanti Komisionit për Integrim Evropian gjatë muajit prill dhe maj, Komisioni ka vendos që realizoj vizita në terren. Për këtë qëllim në fillim të majit ka vizituar Prizrenin dhe Gjakovën, ku ka diskutuar me akter lokal (institucione, shoqërinë civile dhe qytetar) për rrugën që duhet të ndjekur për integrimin evropian dhe ku ndodhet Kosova aktualisht në këtë proces. Këto vizita, Komisioni do të vazhdoj edhe në qendrat tjera regjionale: Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe Prishtinë.

Tryezat e rrumbullakëta

Me qëllim të intensifikimit të përpjekjeve dhe gjetjes së mënyrave më të përshtatshme për Integrimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike, si dhe nxitjen e Qeverisë për përmbushjen e obligimeve për këtë proces, Komisioni për IE,



me mbështetje të partnerëve të jashtëm ka organizuar dy tryeza të rrumbullakëta. Tryeza e parë temë fokusi ka pasur “Mbrotjtja e të drejtave të minoriteteve në procesin e Integrimëve Evropiane”. ndërkaj në tryezën e dytë është diskutuar “Progresi i arritur në realizimin e Planit të Veprimit: Perspektiva e Komisioneve Parlamentare”. Nga këto tryeza janë nxjerrë rekomandime qarta për Qeverinë për ndërmarr veprime konkrete në përmbushjen e obligimeve dhe arritjen e standardeve evropiane, përkatësisht janë analizuar të arriturat e deritanishme në këtë proces dhe të cilat do të pasqyrohen në raportin e rregullt të Komisionit në seancë plenare në muajin korrik.

Aktivitetet e Komisionit në të Ardhmen

Duke u bazuar në Planin e Punës, Komisioni në të ardhmen do të përqendrohen në shqyrtimin e amandamenteve të komisioneve funksionale për Projektligjet në shqyrtim nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e UE-së, monitorimin e punës së Qeverisë për përmbushjen e obligimeve që dalin në procesin e integrimëve si dhe në vazhdimin e ashtuquajturës diplomaci parlamentare për të avancuar pozitën e Kosovës në procesin e integrimëve evropiane.




Monitorimi i procesit të integrimit evropian të Kosovës

Edhe gjatë vitit 2009 Komisioni për Integritime Evropiane, vëmendje të veçantë i ka kushtuar monitorimit të procesit të integritimeve evropiane, me theks të posaçëm zbatimit të Planit të për Integritim Evropian të Kosovës 2008-2010 dhe veprimet e institucioneve ekzekutive lidhur me tejkalimin e sfidave të identifikuar në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008. Për këtë qëllim për të parë progresin e arritur në këtë fushë, Komisioni ka mbajtur kontakte të rregullta me Agjencionin për Integritime Evropiane, si dhe ka ftuar rregullisht zv.Kryeministrin Hajredin Kuçi, dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës, për të raportuar para Komisionit. Përveç, përfaqësueseve të Qeverisë, për të diskutuar për ecurinë e procesit të integritimeve Komisioni ka qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe ka ftuar përfaqësuesit e institucioneve të UE-së në Kosovë, në veçanti Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë.

Statistika

- Mbledhje të komisionit	13
- Vizita	3
- Raportimi i ministrave	3
- Tryeza të rrumbullakëta	2

KOMISIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE



Zylfije Hundozi (AAK)
Kryetare e Komisionit



Bujar Bukoshi (LDK)
Zëvendëskryetar i Parë



Džezair Murati (7+)
Zëvendëskryetar i Dytë



Hydajet Hyseni (PDK)
Anëtar



Edita Tahiri (PDK)
Anëtare



Sabri Hamiti (LDK)
Anëtar



Fatmir Rexhepi (LDK)
Anëtar



Njomza Emini (AKR)
Anëtare



Nait Hasani (PDK)
Anëtar



Naser Rugova (LDD)
Anëtar



Branislav Grbić (SLS)
Anëtar



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përdhes

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Minire Hasani Administratore e Zyrës

038 211 850
minire.hasani@assembly-kosova.org

Ahtere Loxha Zyrtare e Lartë Ligjore

038 211 332
ahtere.loxha@assembly-kosova.org

Adelina Demolli Zyrtare Ligjore

038 213 801
adelina.demolli@assembly-kosova.org

Zyrtari nga NDI që mbështet Komisionin

Avni Zuka Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 409, Kati IV

038 212 532 azuka3@gmail.com
044 513 608

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

